

## BULETINI INFORMATIV JANAR-SHKURT 2022

### INTERVISTË E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM PËR TELEVISIONIN TOP CHANNEL MBI ARRITJET E DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS




#### Rezultate të ndihmës juridike falas 2021

- Janë funksionale 10 qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore
- Bëhet i mundur kalimi i Qendrës Tiranë, si qendra e dytë që mbështetet me buxhtin e shtetit;
- Numri i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit shkoi në njëmbëdhjetë;
- U zhvilluan praktikat 3 mujore të punës të studentëve të agazhuar në Klinikat e Ligjit pranë DNJF dhe qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore;
- U publikua lista përfundimtare e avokatëve ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2021. (Nënshkruajnë kontratë me DNJF, 124 avokatë);
- Janë zhvilluar mbi 125 aktivitete ndërgjegjësuese me fokus promovimin e ndihmës juridike falas.
- Është bërë i mundur trajnimi i detyrueshëm ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore;
- Gjatë këtij viti kanë përfituar ndihmë juridike parësore 8153 qytetarë (2 fishi i rasteve të trajtuara gjatë vitit 2020)
- Gjatë këtij viti kanë përfituar ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore 671 persona (nga 849 vendime gjyqësore në total).

# Totali i rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore për muajin Janar 2022

## 677 raste



## TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE JANAR 2022

61 vendime të administruara

## TRAJNIM I STUDENTËVE NË KOLEGJIN UNËRSITAR “BEDËR”



Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi trajnimin e studentëve të angazhuar pranë Klinikës së Ligjit në Fakultetin e Drejtësisë pranë Kolegjit Universitar Bedër, me temë: *“Ndihma Juridike e Garantuar nga Shteti”*.

Zhvillimi i këtij trajnimi u mbështet në Marrëveshjen e Bashkëpunimit me nr. 75 prot., datë 15.05.2021, me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, dhe konkretisht në nenin 5 të saj ku përcaktohet se: “Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas do të ofrojë kushte për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë klinikës ligjore, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore. Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas trajnon studentët e përfshirë pranë klinikave të ligjit të paktën një herë në vit” Përmes këtij trajnimi studentët patën mundësinë të informohen mbi:

Ndhmën juridike parësore, dytësore dhe ofruesit e shërbimit;

Rolin e Klinikave të Ligjit në ofrimin e këtyre shërbimeve;

Mundësitë për angazhimin me praktika 3-mujore pune pranë DNJF dhe ofruesve të shërbimit.

*SHPREHIM MIRENJOHJE DHE FALËNDERIM PËR  
KOLEGJIN UNIVERSITAR “BEDËR”, PËRFAQËSUESIT E  
KLINIKËS SË LIGJIT DHE STUDENTËT PËR  
BASHKËPUNIMIN E TREGUAR.*



Ndihma ligjore falas e ofruar nga rrjeti i avokatëve të Klinikave të Ligjit përgjatë viteve të fundit ka ndihmuar në përmbushjen e kauzave qytetare dhe arritjen e sukseseve të shumë çështjeve.

Zhvilluam takimin hybrid, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, Znj. Chantal Nicod, Drejtorit Ekzekutiv të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë Z. Andi Dobrush, Drejtorin e Ndhmës Juridike Falas Z. Ergys Qirici, aktivistë të shoqërisë civile, qytetarë, avokatë dhe gazetar ku u diskutua mbi punën e jashtëzakonshme që kjo nismë ka arritur të bëjë duke i qëndruar në krahë qytetarëve dhe komunitete në litigimin e kauzave të tyre, garantimin e aksesit në drejtësi dhe krijimin e precedentëve pozitive në fushën e drejtësisë.

## NDIHMJA LIGJORE, SHOQËRIA CIVILE, KOMUNITETET – TRINOMI I REZISTENCËS QYTETARE



## NDIHMJA JURIDIKE FALAS NJË HAP MË PRANË QYTETARËVE!

Tashmë të gjithë qytetarët të cilët disponojnë në smartphone mund të shkarkojnë platformën juristi online. Nëse ke nevojë për ndihmë juridike mjafton të dërgosh pyetjen dhe juristët e platformës sonë do të përgjigjen në kohë reale duke ofruar ndihmë dhe konsulencë për problemin apo ndihmën ligjore.

Juristi ONLINE – Ndhmë ligjore falas për qytetarët!

WWW.JURISTONLINE.AL  
NDIHMË LIGJORE FALAS

**Juristi Online**

Juristi Online është platforma e vetme që ofron ndihmë ligjore falas 24 orë çdo ditë të javës.

Keni një pyetje për një problem ligjor që lidhet me çështje civile, administrative, familjare, marrëdhëniet e punës apo penale? Kërkonit të nisni një proces ndërmjetësimit për mosmarrëveshjet tuaja dhe ju nevojitet informim apo këshillim?

KËRKO NDIHMËN E JURISTËVE TANË

DËRGO PYETJEN

JURISTI  
ONLINE

APLIKACION MOBILE

NDIHMJA LIGJORE  
NË CELULARIN TUAJ

SHKARKOJE

## TAKIM PRANË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPITAN NË VLORË



Qendra e Sherbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë në bashkëpunim me Organizatën Jofitimprurëse “ Drejtësi Sociale”, organizoi një aktivitet me antarë të komunitetit rom dhe egjiptian në qytetin e Vlorës ku u informuan mbi sistemin e ndihmes juridike të garantuar nga shteti. Qytetarët ndan shqetësimet e tyre në lidhje me problematikat e strehimit, përfitimit të bonusit të qerasë apo banesave me kosto të ulët, përfitimin e pensionit të invaliditetit dhe problematika me njohjen e viteve të punës.

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas ka nënshkruar marrvëshje bashkëpunimi me organizatën jofitimprurëse “*Drejtësi Sociale*” « Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017 « Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti »

# ZHVILLOHET PROCEDURA E SHORTIT PËR PËRGATITJEN E LISTËS DHE CAKTIMIN E AVOKATËVE QË DO TË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE DYTËSORE PËR VITIN 2022



U zhvillua procedura e hedhjes së shortit për përgatitjen e listës dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative për vitin 2022.

Gjatë kësaj procedure është respektuar parimi i rotacionit si dhe të gjitha rregullat e parashikuara në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, me nr.17, datë 05.08.2020, duke garantuar kështu një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Pas miratimit të listës së avokatëve që do të ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, do të vijohet me procedurën e nënshkrimit të kontratave të shërbimit ndërmjet Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe avokatëve të listës së miratuar

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN “ EPOKA”




Nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit me Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale Prof. As. Dr. Lisen Bashkurti për dhënien e ndihmës juridike parësore nga Klinika e Ligjit pranë Universitetit “Epoka”.

Tashmë Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ka nënshkruar 12 marrëveshje bashkëpunimi me Universitetet në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vizitës në Universitetin “Epoka”, patëm kënaqësinë e zhvillimit të një takimi me Rektorin e këtij Universiteti Prof. Dr. Ahmet Öztaş me të cilin ndamë arritjet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe u dakordësua për vijimin e bashkëpunimit në terma më konkretë.

# NDIHMJA JURIDIKE FALAS PËR VIKTIMAT E KRIMIT



Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier së bashku me Organizatën "Të Ndryshëm & Të Barabartë" organizuan një takim në kuadër të projektit "Rritja e aksesit në drejtësi për viktimat e krimit nëpërmjet ofrimit të ndihmës ligjore falas", si pjesë e Projektit "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri", i cili po zbatohet nga (PNUD) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen financiare të (ADC).


Gjatë këtij sesi informimi u dha një informacion i përmbledhur për projektin, bazën ligjore për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, diskutime si dhe iniciativën për krijimin e një "Rrjeti Kombëtar me avokatë, juristë dhe profesionistë të fushës" për të kontribuar në ofrimin e ndihmës ligjore për viktimat e krimit.





## HAPEN PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR PËRFITIMIN E FINANCIMEVE NGA BUXHETI I SHTETIT TË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA NGA MINISTRI I DREJTËSISË PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI

Të gjitha organizatat jofitimprurëse të autorizuar për t'u kualifikuar për të përfituar financime, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në pikën 6 të VKM-së Nr.110, datë 6.3.20219 *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*.



## Kontratat e avokatëve ofrues të ndihmës juridike dytësore ndër vite:

Viti 2017 - 23 avokatë

Viti 2018 - 23 avokatë

Viti 2019 - 70 avokatë

Viti 2020 - 73 avokatë

Viti 2021 - 124 avokatë

Viti 2022 - 202 avokatë



Qendra e Ndhmës Juridike Parësore Durrës, në bashkëpunim me Shoqatën "Të ndryshëm por të barabartë" mori pjesë në sesionin e Informimit për lançimin e projektit "Rritja e aksesit në drejtësi për viktimat e krimit nëpërmjet ofrimit të ndihmës ligjore falas", si pjesë e Projektit "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri", i cili po zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).

Gjatë këtij sesi informimi u dha një informacion i përmbledhur për projektin, bazën ligjore për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, si dhe për iniciativën për krijimin e një "Rrjeti Kombëtar me avokatë, juristë dhe profesionistë të fushës" për të kontribuar në ofrimin e ndihmës ligjore për viktimat e krimit.



Qendra e Ndhmës Juridike Parësore Lezhë në bashkëpunim me Shoqatën "Të ndryshëm por të barabartë" mori pjesë në sesionin e Informimit për lançimin e projektit "Rritja e aksesit në drejtësi për viktimat e krimit nëpërmjet ofrimit të ndihmës ligjore falas", si pjesë e Projektit "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri", i cili po zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).

Gjatë këtij sesi informimi u dha një informacion i përmbledhur për projektin, bazën ligjore për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, si dhe për iniciativën për krijimin e një "Rrjeti Kombëtar me avokatë, juristë dhe profesionistë të fushës" për të kontribuar në ofrimin e ndihmës ligjore për viktimat e krimit.



**Qendra e shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore Pogradec në bashkëpunim me shoqatën 'Une Gruaja' zhvilluan aktivitete informuese mbi Ndhimën Juridike Falas në qytetet : Korçë, Pogradec, Maliq, Devoll, Erseke dhe Pustec**



# Qendra e Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore Lushnje në bashkëpunim me shoqatën e romëve dhe egjiptianëve zhvilloi një takim me temë: "Shërbimi ligjor falas në ndihmë të këtij komuniteti"



## Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër



Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarreveshjeve" ne bashkepunim me Qendra per Zhvillim Komunitar "Sot per te Ardhmen", ne Shkoder, u diskutua nje draft marreveshje bashkepunimi ndermjet Institucioneve Pergjegjese e Drejtesise Penale per te Mitur,

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lezhë së bashku me organizatën Drejtësi Sociale organizoi një takim me antëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian në qytetin e Lezhës ku u informuan rreth ndihmës ligjore që Organizata “Drejtësi Sociale” mund tu ofrojë.

Individët shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me strehimin për familjet e prekura nga tërmeti, të cilat nuk janë akomoduar ende në godinat e ndërtuara nga programet e rindërtimit, papunësinë dhe problematikave të tjera sociale





Në Kamëz u zhvillua takimi me Organizatën “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, në lidhje me Sesionin e Informimit për lançimin e projektit “Rritja e aksesit në drejtësi për viktimat e krimit nëpërmjet ofrimit të ndihmës ligjore falas”, si pjesë e Projektit “Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri”

Gjatë këtij sesi informimi u dha një informacion i përmbledhur për projektin, bazën ligjore për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, si dhe për iniciativën për krijimin e një “Rrjeti Kombëtar me avokatë, juristë dhe profesionistë të fushës” për të kontribuar në ofrimin e ndihmës ligjore për viktimat e krimit.

Gjithashtu gjatë këtij takimi u informua mbi shërbimet që Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ofron bazuar në ligjin Nr. III/2017” Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” për kategoritë në nevojë.

Në kuadër të ndërgjegjësimit të qytetarëve u vijua me shpërndarjen e fletëpalosjeve dhe afishimin e posterave “Si të përfitojmë ndihmë juridike”.



## .Aktivitet në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkues



Më datë 7 u zhvillua aktiviteti informues në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkues, si një prej institucioneve ku janë akomoduar rreth 15 individ dhe 2 familje të ardhur nga Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore, të cilët janë në kushtet e kërkimit të azilit.

Në këtë aktivitet morën pjesë punonjësit, të cilët u pajisën me informacionin e nevojshëm dhe mënyrën si mund ti ndihmojnë, ku duhet ti referojnë dhe cilët nga të strehuarit mund të konsiderohen si objekt i ndihmës juridike falas. Gjithashtu u prezantuan me formularët e aplikimit për shërbimin si dhe materialet informuese të cilat shprehin detajisht të gjitha kushtet dhe format e aplikimit.

Përveç trainimit të punonjësve, azilantët e akomoduar në qendër të cilët kishin pyetje në lidhje me çështjet e tyre ligjore iu ofrua këshillim dhe orientim mbi problematikat e hasura në kushtet e kërkimit të azilit. Gjithashtu iu vendosën në dispozicion të gjitha format e kontaktit në rastet e nevojës të aplikimit për ndihmë juridike falas.

I gjithë takimi u ndoq nga drejtuesi i institucionit Z. Ermir Aliçka, i cili shprehu interes për bashkëpunim.



## Takim në qendrën për të Drejtat në punë, CLR



Më datë 9 u zhvillua takimi në qendër me koordinatoren e saj si dhe u lidh kontakti me drejtuesin e qendrës Z. Hoxha. Në këtë takim u shkëmbyen eksperiencat nga ana e përfaqësuesve të qendrës dhe paralogjorëve.

Si organizatë e cila u vjen në ndihmë individëve me problematika me punëmarrësin, të cilët mund të jenë të papunësuar ose pensionist, si dhe bashkëpunues me grupet e sindikatave edhe nëpër rrethe, iu bë me dije se Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas është institucioni ku mund të drejtojnë individët, të cilët përfshihen në skemën e ndihmës juridike falas, në rastin e hasjes së problematikave.

Në përfundim të takimit punonjësit u pajisën me informacionin mbi funksionimin e ndihmës juridike falas, si mund të nisnin procesin e aplikimit për të qene përfitues të saj, kushtet e aplikimit si dhe iu vunë në dispozicion juristëve të qendrës Manuali për Ndhimën Juridike Falas sëbashku me broshurat informuese.



Me datë 11.01. 2022 pranë Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore Tiranë u zhvillua takimi me Përgjegjësinë e Agjencisë Z. Dëftim Bitri si dhe punonjës të tjerë të kësaj Agjencie

Gjatë këtij takimi u informua mbi shërbimet që Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ofron bazuar në ligjin Nr. III/2017” Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” për kategoritë në nevojë.

Në përfundim të takimit, patëm mundësinë të informojmë qytetarët (kryesisht moshën e tretë), mbi shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti; mënyrën e përfitimit të tyre si dhe vendndodhjen dhe kontaktet e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Drejtorisë e Ndihmës Juridike Falas.

Gjithashtu, në kuadër të ndërgjegjësimit të qytetarëve u vijua me shpërndarjen e fletëpalosjeve dhe afishimin e posterave “Si të përfitojmë ndihmë juridike” pranë ambienteve të Agjencisë.

02.02.2022, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë organizoi një aktivitet në terren pranë zyrave të Gjendjes Civile Vlorë, duke informuar qytetarët, shpërndarë fletëpalosje dhe afishimin e posterave informues, në kuadër të fushatës së ndërgjësimit mbi shërbimin ligjor falas.



**Qendra e Ndhmës Juridike Durrës ka zhvilluar në bashkëpunim me Fondacionin "Së bashku" aktivitetin me temë "Ndhma juridike falas për personat me aftësi të kufizuara"**



# Qendra e Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore Vlorë shpërndau fletëpalosje dhe infomoi qytetaret mbi shërbimet që ofron Qendra, në lagjen "Partizani" pranë Bashkisë Vlorë

